



100 Vjet Pavarësisë

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E APELIT**  
**TIRANE**

Bulevardi "Zhan D'Ark" Tirane, Shqiperi

Tel/Fax 00 355 04 2260284

**URDHËR**

Nr. 111, datë 24.10.2012

**"PËR RASTET E HEQJES DORË TË GJYQTARËVE NGA GJYKIMI I NJË ÇËSHTJE"**

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore", miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Drejtësisë nr. 1830, datë 03.04.2001, dhe në zbatim të rekomandimeve të Raportit të Ministrisë së Drejtësisë "Mbi inspektimin tematik për verifikimin e rregullave të etikës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë", faqe 206§5 dhe 207 (Rekomandimi 1), përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 118/4 Prot., datë 24.09.2012,

**URDHËROJ**

1. Me qëllim shmangien e vonesave të gjykimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Tiranë, si pasojë e heqjes dorë të gjyqtarit/ëve nga gjykimi i një çështje, parashikuar nga neni 73 i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 17 i Kodit të Procedurës Penale, të ndiqen hapat si më poshtë vijon:
  - a. Në momentin e regjistrimit të dosjeve në Gjykatën e Apelit, të evidentohen rastet e mundshme të pjesëmarrjes së gjyqtarëve në gjykime të mëparshme të çështjes në Gjykatën e Apelit ose në Gjykata të tjera.

- b. Të listohen në një dokument të veçantë dosjet gjyqësore me shënimin përkatës lidhur me emrat e gjyqtarëve të cilët rezultojnë të jenë në kushtet e papranueshmërisë së gjykimit të çështjes.
- c. Lista i përcillet Kryetarit të Gjykatës së Apelit për informacion.
- d. Të hidhet shorti i dosjeve gjyqësore të listuara ndërmjet gjyqtarëve, duke përjashtuar gjyqtarët, të cilët rezultojnë se duhet të heqin dorë nga gjykimi i tyre për arsyet e përmendura në pikën a) të këtij Urdhri.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sektori i Kryesekretarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë dhe punonjësja e Teknologjisë së Informacionit.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

  
**ALAUDIN MALAJ**